

MES APATISË DHE NOSTALGJISË

Kujtesa publike dhe private
e komunizmit në Shqipërinë e sotme



Edituar nga **Jonila Godole** dhe **Idrit Idrizi**

© 2019 Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC)

Adresa: Rr. Bardhok Biba, Hyrja A, Kati 11^{te}, Tiranë

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Mes apatisë dhe nostalgjisë

Kujtesa publike dhe private e komunizmit

në Shqipërinë e sotme

Ky botim u mbështet nga

Fondacioni Konrad Adenauer, Zyra Tiranë

Editorë (red.shkenc.):

Jonila Godole

Idrit Idrizi

Përkthyesë:

Ledia Fazlli

Redaktore gjuhësore:

Elona Baçi

Grafika dhe faqesja:

Iceberg Communication

Foto e kopertinës:

“Tubim komunist”, Tiranë 2017 © Valbona Bezati

Shtypshkronja:

Gent Grafik

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Mes apatisë dhe nostalgjisë: kujtesa publike dhe private e komunizmit në Shqipërinë e sotme = Between apathy and nostalgia: public and private recollections of communism in contemporary Albania / edituar nga Jonila Godole, Idris Idrizi; përkth. Ledia Fazlli, Tienmu Ma. – Tiranë: IDMC, 2019. 312 f. ; 15.2 x 23 cm.

Bibliogr.

ISBN 978-9928-4482-2-4

1. Sociologjia politike
2. Komunizmi dhe shoqëria
3. Historia
4. Kujtesa
5. Studime

316.334.3 : 321.64(496.5) “19”(082)

930.2 :94(496.5).09(082)

ISBN 978-9928-4482-2-4



9 789928 448224

Mes apatisë dhe nostalgjisë

Kujtesa publike dhe private e komunizmit në
Shqipërinë e sotme

Edituar nga Jonila Godole dhe Idris Idrizi

INSTITUTI PËR DEMOKRACI, MEDIA DHE KULTURË (IDMC)

Tiranë, 2019

Përmbajtja

Hyrje. Kujtesa dhe paraqitja e komunizmit në Shqipëri në sferën publike dhe private

Jonila Godole & Idris Idrizi

7

Paraqitje dhe diskurse publike

Fantazmat e komunizmit. Studime postsocialiste në Shqipëri dhe rikthimi i së shtypurës komuniste

Federico Boni

15

Rrënojat, trupat dhe piramidat: Eksplorimi i rrënojave komuniste dhe i politikave të kujtesës në Shqipëri

Kailey Rucker

25

Bunk'Art Project – Një vëzhgim në të kaluarën komuniste në Shqipëri

Alsena Kokalari

35

Politika pragmatiste mbi kujtesën dhe harresën. Qëndrime paskomuniste karshi muzeologjisë komuniste në Shqipëri

Konstantinos Giakoumis

47

Të gjithë pro dhe kundër komunizmit. Paradokset në ndryshimin e sistemit politik 1990–1992 dhe kujtesën e tij

Afrim Krasniqi

60

Kujtesa mes sferës publike dhe asaj private

Kujtesa e huazuar e brezit të ri për periudhën e komunizmit

Jonila Godole

72

Tipologjitë e kujtesës private të komunizmit në Shqipëri. Një studim bazuar në intervista gojore në zonën e Shkodrës dhe me fokus të veçantë periudhën e socializmit të vonë (1976–1985)

Idris Idrizi

83

Fotografia dhe kujtesa. Çështje mbi trashëgiminë vizuale të Shqipërisë komuniste
Gilles de Rapper 100

Marrëdhëniet e Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik dhe gjurmët e tyre në kujtesën individuale dhe kolektive
Brisejda Lala 118

Perspektiva nga rajoni

Nostalgjia postsocialiste: Çfarë është dhe si të përballemi me të?
Daniela Koleva 130

Të kujtosh komunizmin në Rumani: Roli i komisioneve historike
Cristian Vasile 141

Apendiks

Programi i konferencës 150

Autorët 154

Hyrje

Kujtesa dhe paraqitja e komunizmit në Shqipëri në sferën publike dhe private

Një anketë e OSBE-së mbi njohuritë dhe perceptimet e shqiptarëve për të shkuarën komuniste ngjalli reagime publike në dhjetor të vitit 2016.¹ Në qendër të vëmendjes ishte perceptimi pozitiv i diktatorit komunist nga pothuajse gjysma e të anketuarve. Kjo u shpjegua kryesisht me mosinformimin e mjaftueshëm të shoqërisë shqiptare mbi diktaturën dhe mungesën e de-komunistizimit ose u trajtua si një nostalgji e motivuar thjesht nga pakënaqësia me kushtet aktuale. Gjithashtu nuk munguan akuzat për njëanshmëri politike të projektit.² Sondazhi dhe reagimet ndaj tij pasqyrojnë (përveç tendencës së politizimit) stadin fillestar, në të cilën gjendet diskutimi dhe hulumtimi i kujtesës së komunizmit në Shqipëri. Studime me një shkallë të ngjashme përfaqësueshmërie, me të cilat mund të krahasoheshin rezultatet e sondazhit të OSBE-së (me një kampion prej 995 vetash), mungojnë. Gjithashtu janë mjaft të kufizuara njohuritë e përfuara shkencërisht mbi gamën e gjerë të përjetimeve individuale të komunizmit, mbi bazën e të cilave mund të diskutohej edhe kujtesa në postkomunizëm. Në përgjithësi dallohet një mungesë e theksuar ndërjegjësimi për kompleksitetin e fenomeneve të përjetimit dhe kujtimit të komunizmit. Në shkencën shqiptare, debate në këtë fushë dhe mbi problemet teoriko-metodologjike në hulumtimin e komunizmit dhe kujtesës së tij janë inekzistente. Kujtimet ose janë injoruar si burim historik ose janë trajtuar si burimet më autentike. Sidoqoftë, në vitet e fundit, sidomos studiues shqiptarë të shkolluar jashtë vendit dhe të huaj kanë shfaqur një interes në rritje për të hulumtuar kujtesën e komunizmit ose së paku për

1. Për studimin (të publikuar në shqip dhe anglisht) ndiq linkun: <https://www.osce.org/sq/albania/286831>, aksesuar më 4.12.2018.

2. Shiko ndër të tjera: Mejdini, Fatjona: Studimi për perceptimin e komunizmit zemëron viktimat e kohës: Reporter.al, 12.12.2016 (<https://www.reporter.al/studimi-per-perceptimin-e-komunizmit-zemeron-viktimat-e-kohes/>, aksesuar më 4.12.2018) / Mejdini, Fatjona: Albania Survey Shocks Victims of Communist Regime: Balkan Insight, 12.12.2016 (<http://www.balkaninsight.com/en/article/albania-struggles-to-fight-the-root-of-communism-nostalgia-12-09-2016>, aksesuar më 4.12.2018); Pse u kthyen enveristët, Mapo, 10.12.2016, (<http://www.mapo.al/pse-u-kthyen-en-veristet/>, aksesuar më 4.12.2018)

ta cekur atë në kuader projektesh me tjetër objekt kryesor hulumtimi.³

3. Studimi më voluminoz dhe i bazuar metodologjikisht dhe teorikisht mbi kujtesën e komunizmit shqiptar është monografia e Georgia Kretsit mbi përndjekjen politike në rajonin e Konispolit dhe strategjitë e kujtimit të saj nga ish- të përndjekurit: Kretsi, Georgia: Verfolgung und Gedächtnis in Albanien. Eine Analyse postsozialistischer Erinnerungsstrategien. Wiesbaden 2007. Monografia e Shannon Woodcock i përdor intervistat gojore kryesisht për të rindërtuar përvojat në komunizëm (Woodcock, Shannon: Life Is War. Surviving Dictatorship in Communist Albania. Bristol 2016). E njëjta gjë vlen edhe për monografinë e Idriz Idrizit (Idrizi, Idriz: Herrschaft und Alltag im albanischen Spätsocialismus (1976–1985). Berlin/Boston 2018.) Vëllimi i vetëm me artikuj kushtuar kujtesës deri më sot është: Godole, Jonila/ Danaj, Sonila (red. shkenc.): Transformimi i medias dhe kujtesa kolektive në Shqipëri/ Media Transformation and Collective Memory in Albania. Tiranë 2015. Me interes është gjithashtu numri i revistës “Albanische Hefte” të Shoqatës së Miqësisë gjermano-shqiptare kushtuar përballjes me të kaluarën komuniste në Shqipëri: Albanische Hefte 3 (2015): Themenschwerpunkt: Vergangenheitsbewältigung. Libri i Fabian Katit mbi kujtesën kolektive të qëndrës antikomuniste në disa zona të Shqipërisë veriore përmban ekstrakte intervistash të zhvilluara, me një hyrje prezantuese mbi projektin në fillim, por pa analizë të formave dhe strategjive të kujtimit (Katit, Fabian: Formësimi i kujtesës kolektive. Ngjarjet në Dukagjin, Malësinë e Madhe dhe Postrribë, 1945–46. Tiranë 2015). Të njëjtën strukturë ka edhe libri: Niegelhell, Anita/ Ponisch, Gabriele: Wir sind immer im Feuer. Berichte ehemaliger politischer Gefangener im kommunistischen Albanien. Wien, Köln, Weimar 2001. Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit ka botuar një numër të madh kujtimesh ish-të përndjekurish, ndër të tjera edhe ciklin e vëllimeve me intervista „Zërat e Kujtesës“ (ndiq linkun: http://www.iskk.gov.al/?page_id=2708, aksesuar më 4.12.2018). Këto vepra përbëjnë burime të rëndësishme, por që mbeten akoma për tu analizuar në të ardhmen nga pikëpamja e mënyrës se si ish- të përndjekurit e kujtojnë komunizmin në retrospektivë dhe se si përballen ata sot me përvojat shpeshherë traumatike të tyre në të kaluarën. Ndër punimet në fushën e gjerë të kujtesës dhe përballjes me të shkuarën komuniste në Shqipëri apo që cekin aspekte të ndryshme të kësaj tematike vlejné të përmenden: Amy, Lory E.: Re-Membering in Transition: The Trans-National Stakes of Violence and Denial in Post-Communist Albania, *History of Communism in Europe*, 1, (2010), 207–224; Austin, Robert C./ Ellison, Jonathan: Post-Communist Transitional Justice in Albania, *East European Politics and Societies* 22/2, (2008), 373–401; Duka, Valentina: Reflections on the Past in Albania in the 1990s, në: Brunnbauer, Ulf (red. shkenc.), (Re)writing History – Historiography in Southeast Europe after Socialism. Münster 2004, 31–53; Elbasani, Arolda/ Lipinski, Artur: Public Contestation and Politics of Transitional Justice: Poland and Albania Compared, *EUI Working Papers* (02/2011); Glos, Walter/ Godole, Jonila: Albanien: Aufarbeitung der kommunistischen Vergangenheit. 2017 (http://www.kas.de/wf/doc/kas_51049-1522-1-30.pdf?171215122516, aksesuar më 4.12.2018); Hemming, Andreas: Justice of Another Kind. Laying Claims to the Past in Post-Dictatorial Albania, *History of Communism in Europe*, 4, (2013) 44–64; Idrizi, Idriz: Zwischen politischer Instrumentalisierung und Verdrängung: Die Auseinandersetzung mit dem Kommunismus in Öffentlichkeit, Geschichtspublizistik und Historiographie im postkommunistischen Albanien, *Jahrbuch für Historische Kommunismusforschung* (2014), 93–106; Ndoja, Davjola/ Woodcock, Shannon: Postmemory and Women’s Displacement in Socialist Albania: Historical Methodologies as Response, në: Mitroiu, Simona (red. shkenc.): Women’s Narratives and the Postmemory of Displacement in Central and Eastern Europe. Palgrave Macmillan, 221–243; Pandelejmoni (Papa), Enriketa: Përfaqje të reja mbi historinë e Shqipërisë në tekstet historike gjatë tranzicionit / New Approaches on the History of Albania in Historical Textbooks During Transition, në: Schrapel, Thomas/ Pandelejmoni, Enriketa/ Pinari, Andi (red. shkenc.): Thirrja për liri. Studime mbi totalitarizmin dhe tranzicionin në Shqipëri/ The Call for Freedom. Studies on Totalitarianism and Transition in Albania. Tiranë 2016, 294–303/ 304–313; Pandelejmoni (Papa), Enriketa: Myth of a Leader: Enver Hoxha’s Role during the Second World War in Contemporary Albanian History Textbooks, në: Lichnofsky, Claudia; Pandelejmoni, Enriketa; Stojanov, Darko (red. shkenc.): Myths and Mythical Spaces. Conditions and Challenges for History Textbooks in Albania and South-Eastern Europe. Göttingen, 2018, 137–150; Vullnetari, Julie/ King, Russell: ‘Women here are like at the time of Enver [Hoxha] ...’. Socialist and Post-Socialist Gendered Mobility in Albanian Society, në: Burrell, Kathy/ Hörschelmann, Kathrin (red. shkenc.):

Duke pasur parasysh stadin fillestar të studimit nga njëra anë dhe gjallërimin e interesit për hulumtimin e kujtesës në vitet e fundit nga ana tjetër, organizatorët e konferencës ndërkombëtare “Mes apatisë dhe nostalgjisë: Kujtesa publike dhe private e komunizmit në Shqipërinë e sotme” mbajtur në Tiranë në datat 17–18 nëntor 2017, e konceptuan atë si një platformë për diskutimin në një kontekst akademik të studimeve aktuale dhe perspektivave të ardhshme. Gjithashtu, pjesëmarrja e dy studiuesve, përkatësisht nga Bullgaria dhe Rumania kishte për qëllim kontekstualizimin dhe krahasimin e rastit shqiptar me vendet e tjera të rajonit.

Ky konceptim i konferencës reflektohet në strukturën dhe përmbajtjen e vëllimit. Qëllimi i tij nuk është trajtimi shterues i një tematike të caktuar, por prezantimi i larmisë së temave studimore (shpesh mjaft specifike) dhe i qasjeve aktuale në këtë fushë mjaft të gjerë. Për arsye praktike vëllimi është ndarë në dy grupe kryesore tematike “Paraqitje dhe diskurse publike” dhe “Kujtesa mes sferës publike dhe asaj private”, megjithëse format e ndryshme të kujtesës ndërthuren në një pjesë të madhe të artikujve.

Federico Boni trajton në një artikull të mbështetur teorikisht, paraqitjen e komunizmit shqiptar në disa punime të viteve të fundit, duke i analizuar këto nëpërmjet lenteve të “kthesës fantazmiste”. Autori e lidh figurën e “fantazmave” me trashëgiminë kulturore të shtypur apo të harruar të komunizmit në akademinë dhe shoqërinë shqiptare. Nisur nga përmbajtja dhe qasja e veprave të analizuara, Boni e vë theksin tek “gjeografia e fantazmave”, e cila interesohet për gjurmët e jetës në rrënojat urbane industriale dhe fantazmat e të braktisurës. Në rastin shqiptar këto janë për shembull bunkerët, Kombinati Metalurgjik i Elbasanit, ndërtesa e Piramidës në Tiranë. Artikulli demonstroi vlerën e “qasjes fantazmiste” për të studiuar kujtesën publike dhe private të së kaluarës problematike komuniste në Shqipëri.

Me “fantazmat” e së kaluarës komuniste prezente në jetën e përditshme të shqiptarëve merret edhe artikulli i Kailey Rocker, i cili i kushtohet “Piramidës”, perceptimit dhe debateve rreth saj. E përruruar në tetor 1988 si muze i diktatorit Enver Hoxha dhe e përdorur pas rënies së

Mobilities in Socialist and Post-Socialist States. Societies on the Move. Basingstoke 2014, 122–147; Vullnetari, Julie/ King, Russell: ‘Washing Men’s Feet’: Gender, Care and Migration in Albania During and After Communism, *Gender, Place and Culture* 23/2 (2016), 198–215; Vullnetari, Julie/ King, Russell: From Shortage Economy to Second Economy. An Historical Ethnography of Rural Life in Communist Albania, *Journal of Rural Studies* 44 (2016), 198–207; Woodcock, Shannon: The Absence of Albanian Jokes about Socialism, or Why Some Dictatorships Are Not Funny, në: Hamilton, Caroline et al. (red. shkenc.): The Politics and Aesthetics of Refusal. Newcastle 2007, 51–66; Woodcock, Shannon: ‘Against a Wall’: Albania’s Women Political Prisoners’ Struggle to be Heard, *Cultural Studies Review*, 20/2, 2014, 39–65.

sistemit në funksione të ndryshme nga qendër kulture te klub kërcimi, kjo ndërtesë u rrezikua të shembej nga qeveria e djathtë pas vitit 2010, gjë që ngjalli protesta. Duke kombinuar perspektivat teorike të “politikave të trupit të vdekur” të Katherine Verdery-t dhe “shkatërrimit” të Anne Stoler-it dhe bazuar në intervista me pjesëmarrësit në protesta dhe observime personale, autorja analizon perceptimin bashkëkohor të kësaj ndërtese. Rocker tregon se si kujtimet dhe kuptimet ekzistojnë gjithashtu edhe në një “stad paraverbal” dhe arrin në përfundimin se protestuesit e rinj në moshë, të intervistuar nga ajo, e asociojnë ish - ndërtesën e përkujtimit të Enver Hoxhës përtej një trupi të vdekur, me një hapësirë të rrënuar, por që ekspozon historinë e kondensuar të qytetit të tyre.

Dy artikuj merren me muzeologjinë. Alsen Kokalari kontekstualizon dhe analizon dy muzetë (ekspozitat) kushtuar periudhës komuniste Bunk’Art 1 dhe Bunk’Art 2, hapur respektivisht në nëntor 2014 dhe nëntor 2016, dhe debatet rreth tyre. Artikulli evidenton në to një qasje të re ndaj komunizmit, të cilën autorja e shikon si të importuar apo të influencuar nga trende ndërkombëtare. Ndër të tjera, Kokalari vë re tendencën për të integruar periudhën komuniste në historinë moderne të Shqipërisë, për ta estetizuar dhe komercializuar këtë të shkuar, si dhe për të demonstruar se Shqipëria e ka lënë pas atë dhe identiteti i saj është i orientuar tërësisht drejt Europës/Perëndimit. Konstantinos Giakoumis trajton qasjen ndaj muzeologjisë komuniste dhe proceset e rikuptimdhënies në tranzicion nëpërmjet shembullit të veprimtarisë së Muzeut Historik Kombëtar. Analiza demonstroi vazhdimësinë në një masë të konsiderueshme të diskursit dominant të dikurshëm nacional-komunist, të veshur me një kuptim të ri në kuadrin e ridimensionimit të çështjeve identitare kombëtare dhe të spastruar nga përmbajtjet e pastra komuniste.

Artikulli i fundit i pjesës së parë të vëllimit, ai i Afrim Krasniqit, i kushtohet një miti në kujtesën kolektive që lidhet me periudhën e ndryshimit të sistemit politik dhe sidomos dy ngjarjeve kyçe që çuan në rënien përfundimtare të regjimit komunist, protestave studentore në dhjetor 1990 dhe rrëzimit të bustit të Enver Hoxhës në shkurt 1991. Duke rindërtuar dhe kontekstualizuar ngjarjet nga njëra anë dhe analizuar kujtesën kolektive dhe institucionale rreth tyre nga ana tjetër, Krasniqi vë re një mospërputhje të theksuar. Ndërkohë që protestat u mbartën vetëm nga një grup shumë i vogël, pothuajse i izoluar nga pjesa dërrmuese e popullsisë që ishte indiferente, hezituese apo refuzuese, në retrospektivë, ndryshimi politik paraqitet si një proces i arritur me pjesëmarrje dhe konsens të gjerë. Duke krijuar ndër të tjera idenë se shqiptarët ishin në formim demokratë, ky mit ka efekte çoroditëse në përballjen e shoqërisë

shqiptare me të kaluarën komuniste.

Pjesa e dytë e vëllimit hapet me një artikull të Jonila Godoles që tipologjizon kujtesën e huazuar të të rinjve që nuk e kanë përjetuar vetë komunizmin. Kujtesa e komunikuar dhe konkretisht ajo familjare janë në qendër të studimit, i cili demonstroi rëndësinë kyçe të rrëfimeve në familje në perceptimin e komunizmit nga të rinjtë. Ndikim kanë së dyti informacionet në media e internet si dhe filmat e prodhuar në komunizëm, ndërsa roli i shkollave në informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre duket mjaft i dobët. Narrativat e kujtimit apo më saktë të paraqitjes së komunizmit dhe reflektimit ndaj tij nga të rinjtë janë simptomatike për procesin e përbaljes me të shkuarën në Shqipërinë postkomuniste. Nga njëra anë mbizotërojnë qëndrimet e prera dhe emocionale, nga ana tjetër paqartësia dhe pasiguria. Përballja (e pamjaftueshme apo e munguar) me të shkuarën përbën një barrë për shoqërinë shqiptare, ashtu sikur kujtesa familjare e komunizmit apo veprimet e familjes në komunizëm për një pjesë të të rinjve të përfshirë në projektin e këtij artikulli. Së fundi, vlen të theksohet ndikimi interesant i teknologjisë në reflektimin mbi të shkuarën. Ndërsa kujtimet në formë eseje ishin shkruar kryesisht në një stil personal dhe emocional, punimet audiovizuale dhe digjitale dallosheshin për një nivel më të lartë reflektimi, analize, mbledhje e përzgjedhje informacioni.

Larmia e mënyrave të kujtimit dhe interpretimit retrospektiv të komunizmit dhe pasiguritë brenda narrativave, përveç karakterit të prerë të tyre në shikim të parë, dallohen edhe në artikullin e Idris Idrizit, i cili tipologjizon kujtesën private të komunizmit (në zonën e Shkodrës), duke u fokusuar në kujtesën e periudhës së vonë. Konformizmi strikt në komunizëm – i evidentuar edhe në artikullin e Afrim Krasniqit në këtë vëllim – i internalizuar dhe habitualizuar nga shumë bashkëkohës, sidomos prej atyre të lindur dhe socializuar në komunizëm, është sipas autorit një arsye e rëndësishme se pse një pjesë e madhe e të intervistuarve e kujtuan komunizmin thjesht si normalitet. Duke iu referuar edhe debateve mbi karakterin e kujtimeve dhe vlerën e tyre si burim, artikulli demonstroi ndikimin e fuqishëm të përvojave mbi narrativat e kujtesës private. Kështu, komunizmi kujtohet tejet negativisht kryesisht nga bashkëkohës që për arsye të biografisë kishin vuajtur diskriminim të rëndë apo edhe të rinj të atëhershëm që duke shikuar fshehtëzi stacione të huaja ishin ndjerë të shtypur e të mjeruar nën regjimin komunist. Ndërkohë, sidomos bashkëkohës që në forma të ndryshme kishin përfituar nga mundësitë e ofruara nga sistemi politik, e asociuan këtë periudhë me sukses, krenari e forcë.

Gilles de Rapper merret me ndikimin e trashëgimisë vizuale të periudhës së komunizmit në kujtesë – një temë mjaft e rëndësishme po të kemi parasysh lidhjen e drejtpërdrejtë të fotografisë dhe kujtesës, por komplet e neglizhuar si nga shkenca, ashtu edhe nga opinioni publik shqiptar. Në këtë artikull, të bazuar teorikisht dhe metodologjikisht, autori shpjegon fillimisht funksionet kujtuese të fotografisë dhe më pas prezanton disa mënyra se si fotografitë e periudhës së komunizmit mund të shfrytëzohen në rastin shqiptar, si objekte historike të prodhuara në të kaluarën, por njëkohësisht edhe imazhe të së kaluarës prezente në të tashmen, vazhdimisht të riinterpretueshme, ashtu si edhe kujtimet.

Së fundi, Brisejda Lala analizon në kuadër të hulumtimit të saj të marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike edhe gjurmët që kanë lënë ato në kujtesën individuale dhe kolektive. Megjithëse në retrospektivë të intervistuarit dënojnë politikën e jashtme të regjimit komunist, vlen të theksohet perceptimi i tyre i atëhershëm në të njëjtën linjë si propaganda. Rrëfimet dhe argumentimet për simpatinë e dikurshme për Stalinin, hidhërimin për vdekjen e tij apo urrejtjen për udhëheqjen sovjetike pas prishjes së marrëdhënieve dëshmojnë – në një linjë me gjetjet e artikujve të Krasniqit dhe Idrizit – horizontin veçanërisht të ngushtë të informacionit dhe reflektimit në kushtet e diktaturës.

Seksioni i tretë i këtij vëllimi përmban dy referimet e studiuesve nga rajoni. Duke u bazuar në hulumtimet e veta dhe rezultatet e studimeve të ndryshme mbi nostalgjinë për komunizmin në Europën Lindore, Daniela Koleva, folësjja kryesore në konferencë, shtjellon dimensionet e ndryshme të këtij fenomeni. Tezat e Kolevës mbi karakterin e nostalgjisë dhe mënyrat e qasjes ndaj saj vlejnë të merren parasysh nga shkenca shqiptare, në mënyrë që ky fenomen i shpeshhasur, por shumë pak i analizuar shkencërisht të merret seriozisht si objekt i rëndësishëm studimi për të kuptuar më mirë shoqërinë shqiptare (post)socialiste dhe sfidat me të cilat është përballur dhe përballet ajo. Së fundi, Cristian Vasile prezanton konceptimin, qasjen, kontributin dhe sfidat në punën e komisioneve historike në Rumani, të krijuara posaçërisht për të hulumtuar diktaturën komuniste (dhe atë ekstreme të djathtë midis viteve 1940 dhe 1944), duke prekur kështu një problem mjaft të debatuar edhe në Shqipëri, që ende mbetet i pazgjidhur.

Artikujt trajtojnë kryesisht tema specifike, një pjesë e të cilave janë evidentuar në kuadër projektesh studimore me tjetër objekt kryesor hulumtimi. Studime me bazë më të gjerë empirike dhe më të thelluara në fenomenet mjaft komplekse të fushës së gjerë të kujtesës së komunizmit do të hedhin dritë mbi përfaqësueshmërinë e gjetjeve të prezantuara këtu.

Sidoqoftë, ky vëllim, duke prezantuar punimet e një konference shkencore ndërkombëtare kushtuar specifikisht kujtesës së komunizmit shqiptar, synon të ofrojë sadopak një kontribut në këtë fushë dhe të shërbejë si impuls për rritjen e interesit në shkencën dhe shoqërinë shqiptare ndaj hulumtimit dhe diskutimit të kujtesës së të shkuarës në diktaturë.

Në fund, redaktorët dëshirojnë të falenderojnë përzemërsisht të gjithë ata që kontribuan për këtë libër: autorët e artikujve për bashkëpunimin e shkëlqyer; pjesëmarrësit e tjerë të konferencës që nuk arritën të dorëzonin punimin, por me referatet dhe diskutimet e tyre dhanë impulse të vryera (shiko apendiksin në fund); Tienmu Ma, Ledia Fazlli, Elona Baçi, Kailey Rocker për përkthimin dhe redaktimin e përkushtuar; Fondacionin Konrad Adenauer që mbështet aktivitetet e IDMC-së, si dhe Matilda Karçanaj për punën e palodhur gjatë konferencës shkencore dhe për botimin e produktit të saj që keni në duar.

Jonila Godole dhe Idriz Idrizi

Paraqitje dhe diskurse publike

Fantazmat e komunizmit

Studime postsocialiste në Shqipëri dhe rikthimi i së shtypurës komuniste

Federico Boni

Universiteti i Milanos

Hyrje

Një fantazmë po e përndjek Shqipërinë – fantazma e komunizmit. Artikulli synon të shqyrtojë një lloj të veçantë kujtimi të komunizmit në Shqipërinë bashkëkohore, që është komunizmi si një temë kërkimore në studimet bashkëkohore shqiptare. Megjithëse shkencat ndërkombëtare e studimeve komuniste dhe postkomuniste është mjaft e përhapur, në shkencat shoqërore shqiptare kjo çështje është relativisht e re. Studiuesit shqiptarë duket se e kthejnë tabunë politike të komunizmit në një tabu shkencore dhe se puna kërkimore mbi të kaluarën duket se prodhon vepra vlerësuese-gjyquese dhe moralizuese, të cilat ndihmojnë në krijimin e tabuve të reja në funksion të regjimeve të reja të së vërtetës në shoqërinë shqiptare. Sidoqoftë, në vitet e fundit studimet kulturore shqiptare dhe studimet (postsocialiste) kanë prodhuar një “brez të ri” veprash të fokusuara në një vetëreflektim kritik.

Artikulli synon të analizojë këtë valë të re akademike të përquenduar në të kaluarën komuniste shqiptare përmes lenteve të një “kthese fantazmiste”, e cila i sheh hijet dhe përndjekjet si mjet analitik dhe metodologjik i bindshëm për shkencat humane, kulturore dhe shoqërore. Në qendër të shprehjes idiomatike “kthesë fantazmiste” janë një sërë konceptesh që janë bërë gjithnjë e më të rëndësishme në studimet bashkëkohore ndërdisiplinore, të tilla si trauma, misteri, vajtimi dhe kujtesa. Fantazmat, në këtë rast, janë pjesë e një simptomatologjie të shtypjes dhe të kujtimit dhe figura e fantazmës prezanton hijet e trashëgimisë kulturore të shtypur apo të harruar të komunizmit në akademinë dhe shoqërinë shqiptare. Analizuar nëpërmjet kësaj “kthese fantazmiste”, studimet postsocialiste dhe kulturore shqiptare ofrojnë një argument bindës për një interes të vazhdueshëm në fantazmat e zhurmshme të kulturës shqiptare dhe “ftojnë” shkencën kombëtare dhe ndërkombëtare në një seancë me të kaluarën komuniste të papërfunduar shqiptare.

1. “Kthesa fantazmiste” në studimet kulturore

Në vitet e fundit shkencat humane dhe shoqërore kanë pësuar atë që Roger Luckhurst (2002) e ka quajtur “kthesë fantazmiste”, që është një interes akademik gjithnjë e në rritje mbi hijet dhe përndjekjet. Sigurisht, ka dallime në mënyrat me të cilat mund të merremi me hijet. Studimet letrare dhe kulturore kanë tendencën t’i shohin ato si një shenjë apo një indeks i diçkaje tjetër, qoftë kjo frika apo ankthi i kulturës, ku fantazma edhe i përfaqëson këto, edhe refuzohet dhe shtypet kur kërcënon stabilitetin e shoqërisë. Autorë të tjerë kanë ndjekur “Hijet e Marksit” të Derrida-s (1994), i cili formulon një “hauntologji” të përgjithshme, në dallim nga “ontologjia” tradicionale, ku hija dhe përndjekja përfaqësojnë përvojën e një pranije të munguar, atë të “tjetrit” si një fantazmë (me kusht që supozohet vdekja e subjektit), një *khintar* që gjithmonë kthehet mbrapsht. Sipas Derrida-s ne duhet të mësojmë të mos e vajojmë këtë vdekje, sepse kjo do të ishte heshtja e hijeve të asaj që nuk është më dhe asaj që akoma s’është shfaqur. Hauntologjia është më tepër një përpjekje për t’i dhënë një domethënie produktive aspekteve të munguara, misterioze dhe tmerruese të jetës bashkëkohore, duke mos i shtypur, por duke i pranuar ato. Në fund të fundit, ajo çka fantazmat na kujtojnë është se ekziston një pamundësi shprehjeje thelbësore për përvojën njerëzore, shumë më e dallueshme në momentin e traumës.

Të gjitha kompleksitetet e përndjekjes janë të lidhura me njëra-tjetrën në veprën e Avery F. Gordon *Ghostly Matters* (Çështje fantazmash), një eksplorim në *Përndjekjet dhe imagjinatën sociologjike* (1997). Gordon argumenton se sociologët nuk duhet të jenë *gjuetarë fantazmash*, por *pëshpëritës fantazmash*. Meqenëse e kaluara gjithmonë e përndjek të tashmen, sociologjia duhet të arrijë në mënyrë imagjinare të përballet me ato shfaqje hijesh, pasi ato regjistrojnë “krahun shkaktar ose humbjen e pësuar nga një dhunë sociale e bërë në të kaluarën ose në të tashmen” (ibid: xvi). Për të studiuar fenomenet sociale ne duhet të përballemi me aspektet shpirtërore të tyre, sepse fantazmat (shpirtrat, hijet) janë figura shoqërore: “çështjet shpirtërore janë pjesë e jetës shoqërore. Nëse duam të studiojmë mirë jetën shoqërore dhe nëse përveç kësaj dëshirojmë të kontribuojmë, qoftë në një masë të vogël, për ta ndryshuar atë, duhet të mësojmë se si të identifikojmë përndjekjet dhe të marrim në konsideratë fantazmat, duhet të mësojmë se si të përballemi me atë që shpesh është padyshim e dhimbshme, e vështirë dhe turbulluese” (ibid: 23).

Duke ndjekur Derrida-n dhe Gordon-in, ne do të argumentojmë se përndjekja është diçka që përfshin pasiguri, heterogjenitet, shumëtra-

jtshmëri dhe papërcaktueshmëri. Ajo përdor figurën e fantazmës për të ndjekur si një hije dhe, në këtë mënyrë, kërkon drejtësi ose të paktën një përgjigje.

Më e rëndësishme për temën tonë është se metafora konceptuale e “të sjellurit si një fantazmë” është e rrënjosur veçanërisht në diskursin e kujtesës, të rimëkëmbjes dhe të kujtimit që portretizon projektin multi-disiplinor të studimeve të traumave. Siç pohon Cathy Caruth, të qenurit i traumatizuar do të thotë “të pushtohesh nga një imazh apo ngjarje” që gjendet në të kaluarën (Caruth 1995: 5). Të qenët “i pushtuar”, gjithashtu, përshkruan statusin e të qenit i përndjekur. Kur mendojmë për histori me fantazma, narrativa më dominuese është pikërisht përndjekja e së tashmes nga e kaluara. Memoria posttraumatike nuk është thjesht një “simptomë e pavetëdijes”, por – më e rëndësishmja – është gjithashtu një “simptomë e historisë”. Trauma kërkon një përgjigje, një të vërtetë jetëshkurtër. I tillë është rasti me fantazmat që vijnë nga e kaluara, që kërkojnë të krijojnë një dialog etik me të tashmen. Fantazmat, në këtë rast, janë pjesë e simptomatologjisë së traumës, pasi ato bëhen njëkohësisht objekt dhe metaforë për një përvojë historike të plagosur.

Për më tepër, nocioni i të sjellurit si një fantazmë mund të lehtësojë të kuptuarit jo vetëm të padrejtësive historike dhe të përkujtimit të tyre në memorien individuale dhe/ose kolektive, por edhe të situatave të padrejtësisë dhe pafuqisë që lindin në dhe nga një e tashme e karakterizuar nga një proces difuz i globalizimit – dhe, në rastin e Shqipërisë, një proces difuz i kapitalizmit neoliberal.

Një nga çështjet më interesante të kthesës fantazmiste është ajo e *gjeografive fantazmiste (spectro-geographies)* (Maddern dhe Adey, 2008). Disa gjeografë sugjerojnë se një harmonizim i kujdesshëm me shpirtëroren, hijen dhe të munguarën mund të jetë një mënyrë veçanërisht efektive për t’u përballur me një sërë çështjesh të rëndësishme për mendimin gjeografik bashkëkohor. *Gjeografia fantazmiste* përdoret si një mjet teorik dhe metodologjik për të kërkuar në gjurmët e jetës të endura nëpër rrënojat urbane industriale dhe fantazmat e së braktisurës, rezonancë e çuditshme e historive “pa zë” postkoloniale dhe postkomuniste. Në këtë mënyrë, të sjellurit si fantazmë kuptohet përmes interpretimit shpirtëror të hapësirës, objekteve dhe artefakteve materialeve, me fokus të veçantë në substancën dhe në konkretësinë e hapësirës urbane dhe rurale që sjell fantazmat dhe përndjekjet e të kaluarës së shtypur (por jo të harruar).

Në këtë mënyrë, Tim Edensor (2005) i kërkon “fantazmat e vendit” në rrënojat industriale – shkretoret, punishtet dhe fabrikat e braktisura – vende marginale që vazhdojnë të ndotin qytetet postindustriale gjith-

një e në rritje të Perëndimit. Hapësirat tona bashkëkohore vazhdojnë të përndiqen nga vendet e lëna pas dore, të asgjësuara dhe të shtypura, më e dukshme në vendet marginale ku nuk mund të bëhet krejtësisht ekzor-cizmi i këtyre kujtimeve të shpirtrave. Në këtë rast, fantazmat thirren përmes planifikimit dhe kontestimit të vendeve të kujtesës, nëpërmjet rishqyrtimit të ngjarjeve ose vendeve të harruara. Këtu jomaterialiteti i fantazmave ndesh materialitetin e hapësirave ku jetojmë. Nëpërmjet proceseve të kalbjes dhe ndërhyjes jonjerëzore, objektet në rrënojat gradu-alisht transformojnë karakterin e tyre dhe humbasin diskrecionin e tyre. Ato vishen me cilësi estetike alternative, imponojnë materialitetin e tyre mbi përvojën shqisore të vizitorëve dhe ngjallin fantazmat e harruara të atyre që u dërguan në të kaluarën pas mbylljes së fabrikës, por që vazhdojnë të përndjekin atë godinë. Në të tilla mënyra, materia e shkatërruar ofron rrugë për të bashkëvepruar ndryshe me botën materiale.

Në këtë mënyrë, Justin Armstrong (2010) reflekton mbi mundësinë e përfshirjes në një lloj etnografie të mungesës, antropologji e njerëzve, vendeve dhe gjërave që janë hequr, fshirë dhe braktisur në rrjedhat e kohës dhe hapësirës. Këtu autori sugjeron një mënyrë hetimi etnografik që realizon një arkeologji të së tashmes së zbrazur dhe të hapësirave boshe të kulturës. Kështu, antropologjia i jep kredibilitet fantazmës si figurë sociale dhe i cakton etnografisë detyrën e ndjekjes së fantazmave nga një shqetësim për të kaluarën dhe të tashmen. Duke ndjekur këto drejtime, Lars Meier et al. (2012) ka bërë një etnografi që lidh punishtet industriale të përhumbura dhe emocionet e humbjes me një kuptim të ndjesive të lidhura me vendin brenda kujtimeve të punonjësve të metalit. Punëtorët përshkruajnë se si ata, kur vizitojnë ish-vendet e tyre të punës, u duhet të përballen me hijet e së kaluarës dhe përmes këtyre përvojave të përndjekjes identiteti i klasës së tyre merr një ekzistencë të re, por shpesh të dhimbshme.

2. Një “kthesë fantazmiste” në studimet postsocialiste shqiptare?

Deri tani kemi parë rezultatet më interesante të “kthesës fantazmiste” në fusha të ndryshme akademike, dhe në studimet kulturore në veçanti. Disa nga autorët e gjeneratës së re të studimeve postkomuniste shqiptare duket se kanë përqaftuar këtë qasje fantazmiste, në veçanti *gjeografinë fantazmiste*, e cila lidh përvojën e përndjekjes në vende të caktuara, ku mungesat e hapësirave dhe vendeve, të lidhura me prezencat dhe mungesat e vazhdueshme të kujtesës dhe historisë (si individuale dhe kolektive), janë ringjallur me anë të shpirtërores (figura e fantazmës).

Një nga “fantazmat” më interesante të peizazhit shqiptar është ajo e bunkerëve, të cilat formojnë një lloj skeleti të çuditshëm dhe fantazmash në të gjithë vendin. Një studim nga Elian Stefa dhe Gyler Myditi (2013) merret me këtë fantazmë që përndjek jetën e përditshme të shqiptarëve. Bunkerë të mëdhenj dhe të vegjël që ndodhen në zonat turistike shpesh janë pikturuar me shkëlqim ose janë shndërruar në bare ose restorante plazhi. Akti i pikturimit ose ripërdorimit të bunkerëve përbën një risi për këto struktura të Luftës së Ftohtë dhe zvogëlon nivelin e frikës që ato njëherë e një kohë posedonin. Megjithatë, kjo hije përndjek kujtesën e shqiptarëve në mënyra shumë të paparashikuara. Të dy autorët tregojnë se ajo që u ndërtua për të komunikuar me botën e jashtme dhe popullin shqiptar, refuzimi i çdo forme të drejtpërdrejtë të ndërveprimit (dhe një kontroll i fortë nga shteti) është një kthimtar i ringjallur që përndjek tokën shqiptare si një hapësirë e konvertuar në reflektim në fantazinë e bunkerit dhe bunkerizimin. Shumë nga bunkerët janë shndërruar në ndërtime të shkatërruara kthyer natyrës, të cilat janë shumë të ngjashme me gërmadhat e studiuara nga Tim Edensor (2005) në lidhjet e tyre me kujtesën dhe të kaluarën – një prani gotike dhe shpirtërore që i turbullon kufijtë midis të kaluarës dhe së tashmes. Nga njëra anë, bunkerët ofrojnë një mundësi për kujtimin dhe të kuptuarit e një periudhe traumatike të historisë së hershme shqiptare; nga ana tjetër, ato përbëjnë një mundësi unike jo vetëm për etiketimin global, por edhe për zhvillimin e infrastrukturës. Pajtimi me gjurmët fizike të kësaj historie është një rrugë drejt pajtimit emocional dhe psikologjik me vetë traumën, marrë nga një përvetësim i ri i një panorame të traumës (shih gjithashtu Galaty et al. 2009).

Emily Glass (2016) propozon një studim mbi “kujtimet konkrete” të lidhura me prodhimin kulturor në një fabrikë komuniste shqiptare, bazuar në një “etnografi fantazmiste” të një ish-fabrike betoni (Ndërmarrja e Ndërtimit, Gjirokastër), ku janë prodhuar objekte të shumta betoni për të ndihmuar modernizimin e vendit. Ajo vizitoi fabrikën me disa ish-punëtorë për të folur për kohën kur kishin punuar atje. Glass ndjek një qasje fantazmiste kur argumenton se fabrika e Gjirokastrës është në një gjendje pjesërisht të shkatërruar, e cila sipas Edensor-it (2005, 317) e vendos atë në një pozicion të paqartë: e kalbur, por ende ekzistuese dhe e lirë për përdorim në ndërtimin e mjeteve, pjesëve të ndërtimit dhe praktikave. Ajo argumenton se fabrika e Gjirokastrës të jep një ndjesi të “*Ghosts of Place*” (Fantazmat e Vendit) të Bell-it (1997) lidhur me rrethinat e saj. Ashtu si shumë prej relikeve të komunizmit dhe ndërtesave të braktisura të Shqipërisë, ekziston një ndjesi e gjerë shpirtërore e një pranije që ndihet, e cila zotëron dhe ngjall një ndjenjë gjallërie shoqërore në hapësirë (ibid., 815).

Glass argumenton se ndërtesat janë të lidhura me kujtimet personale dhe kolektive në psikikë nëpërmjet ritualeve të përdorimit të përditshëm funksional ose nga prania e një strukture në terren. Kujtimet i bashkohen strukturës së tyre dhe kujtimet mund të thirren me anë të vështrimit të thjeshtë të një ndërtese; kujtimet kolektive të arkitekturës mund të zhvillohen kështu përmes shkëmbimeve individuale midis njerëzve në kohë ose nëpërmjet ndërveprimit të vazhdueshëm me mjedisin e ndërtuar. Këto mund të jenë të kontestueshme, të ndryshueshme ose të homogjenizueshme, por në fund të fundit ato krijojnë një qëndrim të përbashkët për përfaqësimet e së kaluarës. Kështu, duke qenë në hapësirën e fabrikës me të intervistuarit në nxehtësinë e ndenjtur dhe qetësinë e pluhurosur, krijoi ndërjegjen për ndjenjën hapësinore dhe kohore të vendit brenda diskutimeve, përtej asaj që do të ishte përcjellë nga komoditeti i një kafeneje me ajër të kondicionuar. Në të vërtetë, ishte një ndjenjë e vazhdueshme e një jehone prekëse, një iluzion i veprës së Bell-it, kur ai theksoi se fantazmat e vendit “nuk janë kurrë të vdekura, edhe pse mund të jenë të të vdekurve, si dhe të të gjallëve” (1997, 816).

Një qasje e ngjashme është ajo e Olsi Lelajt dhe Nebi Bardhoshit (2016). Edhe pse nuk i referohen në mënyrë eksplicite *gjeografisë fantazmiste* si Glass, kohët e fundit ata përdorën atë që mund ta quajmë një “etnografi fantazmiste”. Të dy antropologët iu bashkuan një nisme të sponsorizuar nga Ministria e Kulturës dhe inauguruar nga Kryeministri – një projekt të artit bashkëkohor me titull “Mendje informale”, që u zhvillua mes datave 11 dhe 15 tetor 2014 në ish-kompleksin metalurgjik të Elbasanit. Detyra e tyre ishte të krijonin për rastin në fjalë një tregim antropologjik për këtë kompleks industrial të ndërtuar gjatë komunizmit. Në vend që të prodhonin një *metanarrativë*, Lelaj dhe Bardhoshi vendosën ta paraqesin dhe të kuptojnë kompleksin e vjetër metalurgjik nga këndvështrimi i njerëzve që punonin atje gjatë komunizmit. Ata kaluan ditë duke biseduar dhe intervistuar intensivisht katër punëtorë që kishin punuar atje gjatë viteve '60, qysh në fillim të ndërtimit të *Kombinatit*. Siç argumentojnë autorët, reflektimet e punëtorëve “janë pjesë e një gjëegjëze më të gjerë, që portretizon nevojën për të pranuar “drejt” të kaluarën. Ideja e paraqitjes së “drejtë” të së kaluarës reflektohet në marrëdhëniet specifike dhe delikate midis politikës, historisë, etikës, moralit dhe të përditshmes në Shqipërinë postsocialiste” (ibid: 5).

Ajo që është më interesante këtu, sidoqoftë, është se vendi i *Kombinatit* konsiderohet jo vetëm për atë që përfaqëson aktualisht, por edhe si një përvojë e mëparshme. Në kujtesën e punëtorëve, pragu fantazmist midis prezencës dhe mungesës krijohet nga marrëdhënia midis asaj që ha-

sin sot dhe asaj që ata kujtojnë nga përvojat e tyre të mëparshme në vendin e punës, përpara se transformimi të ndodhte. Strukturat e mëparshme, të cilat tani mungojnë, dalin të gjalla në kujtimet e tyre si përndjekëse, të cilat në fakt janë mungesa të pranishme. Përndjekja përjetohet pikërisht nga punëtorët që vizitojnë vendin e tyre të mëparshëm të punës dhe zvarritet në mënyrë të pavetëdijshme në intervistat e tyre biografike. Gjeografitë, vendet dhe identitetet e përditshme nuk janë pa një të kaluar dhe, pikërisht, nëpërmjet përndjekjes së përjetuar nga punëtorët kjo e kaluar dhe dhuna shoqërore që mund të ketë ndodhur arrin të shikohet dhe të kujtohet.

Hulumtimi i Ilir Parangonit mbi rrënojat industriale shqiptare (Parangoni 2015), ndonëse bazuar në një perspektivë arkeologjike, është vendosur në mënyrë implicite në diskursin e të kaluarës së shtypur përndjekëse, fantazmiste dhe kulturore. Parangoni pranon se trashëgimia industriale shqiptare është e veçantë për Shqipërinë dhe komunitetet e saj, pasi ajo është diçka që është krijuar dhe përdorur nga vetë shqiptarët. Vetë kujtimi i *ndërtimit* të kombineve dhe veprave metalurgjike dhe tekstile është një trashëgimi e paprekshme e Shqipërisë komuniste, po aq e rëndësishme sa trashëgimia e preکشme e rrënojave dhe vendeve të rindërtuara.

Nëse qasja e Lelajt & Bardhoshit dhe Parangonit nuk është plotësisht ajo e “kthesës fantaziste”, Raino Isto e analizon politikën e kujtesës në Shqipërinë postsocialiste me një qasje tërësisht fantazmiste. Në një artikull të kohëve të fundit (2016), Isto shqyrton Monumentin e Pavarësisë së Tiranës, që u inaugurua për herë të parë në nëntor 2012 me rastin e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë nga Perandoria Osmane. Monumenti, i projektuar nga Visar Obrija dhe Kai Roman Kiklas, shpejt ra në gjendje të keqe derisa u rinovua kohët e fundit në nëntor 2015. Isto analizon funksionin e monumentit në aspektin e ekzistencës së tij dyfishe si një shenjë e lindjes së përjetshme (mundësia e rilindjes së vetëdijes së kombit) dhe si një rrënojë me një pseudoprani të hijeve (si një objekt që vazhdimisht na kujton shkëputjet që ndajnë të tashmen nga historia e saj). Ai argumenton se rrënimi gradual i monumentit mes viteve 2012 dhe 2015 mund të lexohet si një manifestim i veçantë i historisë së imazhit në shoqërinë e vonë kapitaliste. Isto argumenton se “shkatërrimi dhe rilindja e monumentit janë emblematiche për një sërë vështirësish që lidhen me imazhin e marrëdhënieve midis së kaluarës së Shqipërisë dhe të tashmes së saj, dhe, në veçanti, për të paraqitur në mënyrë efektive historizimin e kushteve socio-politike aktuale të Shqipërisë, të dominuara nga neoliberalizmi” (ibid: 9–10).

Karakterit prej fantazme i këtij monumenti të shkatërruar dhe të rilindur është në kontrast me një tjetër lloj “monumenti” të shkatërruar dhe plot me shpirtra, Piramidën në Tiranë, një nga ndërtesat më ikonike të periudhës komuniste të pranishëm në kryeqytet. Kohët e fundit, Francesco Iacono dhe Klejd Këlliçi (2016) kanë ndërmarrë një studim për të kuptuar se si perceptohet ky monument nga një mostër qytetarësh të Tiranës. Kur u pyetën rreth planit për të shkatërruar Piramidën, shumica e të anketuarve kundërshtuan fuqimisht. Autorët argumentojnë se, ndonëse një nga monumentet më të njohura në Tiranë, Piramida është mjaft bashkëkohore, pasi u përfundua në vitin 1988. Kjo do të thotë që brezat e vjetër nuk patën kohë për të zhvilluar një “marrëdhënie të veçantë” me monumentin. Përveç kësaj, përdorimi i saj si muze i Enver Hoxhës zgjati vetëm katër vjet dhe përdorimi i saj pas rënies së komunizmit u shtri për një kohë shumë më të gjatë. Për këtë arsye, ndërtesa lidhet më shumë me Tiranën si një qytet sesa me komunizmin ose posaçërisht me Enver Hoxhën.

Konkluzione

Shembujt e paraqitur në këtë artikull synojnë të tregojnë efektivitetin e një qasjeje “fantazmiste” në çështjen e kujtesës publike dhe private në Shqipëri në postkomuniste. Autorët dhe studimet e paraqitura këtu përqendrohen te fantazma lidhur me fushën e historisë dhe të kujtesës, si dhe në çështjen e potencialit heuristik të metaforave të përndjekjes në fushën e gjerë dhe ndërdisiplinore të studimeve postsocialiste. Çështjet e rëndësishme që mbulohen janë figura e një fantazme si një mjedis i kujtesës kulturore të trazuar, roli i përndjekjes si një metaforë për të përshkruar proceset e transmetimit kulturor të së kaluarës problematike dhe, më në përgjithësi, teoria e kujtesës si përndjekëse.

Brenda këtyre veprave, fantazmat nuk shfaqen si kthimtarë tmerrues, por si të mirëpritur, e nëse janë shqetësuese, nxisin vetëdijen dhe bëjnë thirrje për veprim politik dhe shoqëror. Për më tepër, të vdekurit këtu nuk vijnë si protagonistët e një historie të shtypur të treguar nga të tjerët, por si kthimtarë *agjentiv*.

Përmes eksplorimeve të konceptit të përndjekjes në veprat e paraqitura, ne mund të hetojmë kontekstet shoqërore, politike dhe kulturore në të cilat fantazmat prodhohen, takohen, thirren dhe dëbohen. Në të njëjtën kohë, mund të argumentohet për potencialin e përndjekjes si mënyrë eksperience, njohjeje emocionale, mënyrë dijeje dhe një lloj vetëdijeje

politike dhe kritike brenda dijeve kombëtare dhe ndërkombëtare në studimet postkomuniste shqiptare.

Referenca

Armstrong, J. (2010) *On the Possibility of Spectral Ethnography*, në «Cultural Studies ↔ Critical Methodologies», 10, 3, f. 243-250.

Bell, M.M. (1997) *The Ghosts of Place*, në «Theory and Society», 26, 6, f. 813-836.

Caruth, C. (red. shkenc.). (1995) *Trauma: Explorations in Memory*, Baltimore, Johns Hopkins University Press.

Derrida, J. (1994) *Specters of Marx: The State of the Debt, the Work of Mourning, and the New International*, New York, London, Routledge.

Edensor, T. (2005) *The ghosts of industrial ruins: ordering and disordering memory in excessive space*, në «Environment and Planning D: Society and Space», 23, f. 829-849.

Galaty, M.L., Stocker, S. dhe Watkinson, Ch. (2009) *The Snake that Bites. The Albanian Experience of Collective Trauma as Reflected in an Evolving Landscape*, në: K. Brown Golden dhe B.G. Bergo (red. shkenc.), *The Trauma Controversy. Philosophical and Interdisciplinary Dialogues*, Albany (NY), Suny Press.

Glass, E. (2016) *Concrete Memories: Cultural Production in a Communist Albanian Factory*, in H. Orange (red. shkenc.), *Reanimating Industrial spaces: Conducting Memory Work in Post-Industrial Societies*, New York, Routledge.

Gordon, A. (2008) *Ghostly Matters. Haunting and the Sociological Imagination*, Minneapolis, London, University of Minnesota Press.

Iacono, F dhe Këlliçi, K.L. (2016) *Exploring the public perception of Communist Heritage in Post-communist Albania*, në «Ex Novo – Journal of Archaeology», 1, 1, fq. 55-69.

Isto, R. (2016) *The Monument as Ruin: Natality, Spectrality, and the History of the Image in Tirana Independence Monument*, në «SIC – A Journal of Literature, Culture and Literary Translation», 6, 2, f. 1-31.

Lelaj, O. (2016) *Let's talk about «Communism»! Notes on politics, knowledge*

production and ethics in contemporary Albania, në «Rivista di Antropologia e Scienze Sociali», 16.

Luckhurst, R. (2002) *The contemporary London Gothic and the limits of the 'spectral turn'*, në «Textual Practice», 16, 3, f. 527-546.

Maddern, J.F. dhe Adey, P. (2008) *Editorial: spectro-geographies*, në «Cultural Geographies», 15, 3, f. 291-295.

Meier, L., Frers, L. dhe Sigvardsdotter, E. (2013) *Encounters with haunted industrial workplaces and emotions of loss: class-related senses of place within the memories of metalworkers*, në «Cultural Geographies», 20, 4, f. 467-483.

Parangoni, I. (2015) *Between Glory and Fall. Albania and the industrial experience*, Tirana, Centre for Albanian Cultural Heritage (Qendra Trakult).

Stefa, E. dhe Myditi, G. (2013) *Concrete Mushrooms: Reusing Albania's 750.000 Abandoned Bunkers*, Barcelona, Actar.

Për të lexuar më tej, lutemi të kontaktoni me
Institutin për Demokraci, Media dhe Kulturë

www.idmc.al

Apendiks

Programi i konferencës¹

17 November	
9:00 - 17:00 Venue: Tirana International Hotel, Classic Conference Room <i>International Conference “BETWEEN APATHY AND NOSTALGIA: Public and Private Recollections of Communism in Contemporary Albania”</i>	
9:00 - 9:30	Welcoming Coffee
9:30 - 10:00	Opening Speeches <i>Hildigund Neubert</i> , Former Commissioner for STASI files in Thüringen Representative of the Ministry of Education, Sports & Youth
10:00 - 10:45	KEYNOTE SPEECH <i>Daniela Koleva</i> , St Kliment Ohridski University of Sofia Post-Socialist Nostalgia: What Is It and What to Do About It? <i>Moderator: Jonila Godole</i> , University of Tirana & IDMC
10:45 - 12:00	Session 1: POLITICS OF MEMORY <i>Rigels Halili</i> , University of Warsaw & Nicolaus Copernicus University of Toruń Remembering Communism The Interplay between Work on Memory and Work of Memory in Albania and Poland <i>Sokol Lleshi</i> , European University of Tirana Restoration of Tradition: Institutional Effects on Cultural Battles over Memory <i>Afrim Krasniqi</i> , University of Tirana & Albanian Institute for Political Studies (ISP) Everybody Pro and Against Communism: Paradoxes in the Change of the Political System and Attitudes Towards Communism (1990–1992) <i>Moderator: Elidor Mëshilli</i> , Hunter College, City University of New York
12:00 - 12:15	COFFEE BREAK

1. Konferenca ndërkombëtare i zhvilloi punimet kryesisht në anglisht. Për më shumë informacione shiko: <https://idmc.al/en/between-apaty-conference.html>.

12:15 - 13:00	<p>Session 2: COMMUNIST HERITAGE IN THE URBAN SPACE <i>Kailey Rocker</i>, University of North Carolina, Chapel Hill Ruins, Bodies, and Pyramids: Exploring Communist Ruins and Memory Politics in Albania <i>Ilir Parangoni</i>, Albanian–American Development Foundation Debating the Handling of Communist Ruins Moderator: <i>Francesco Iacono</i>, University of Cambridge</p>
13:00 - 14:00	LUNCH
14:00 - 14:45	<p>Session 3: COMMUNISM IN THE MUSEUMS <i>Alsena Kokalari</i>, Panteion University of Social and Political Sciences, Athens Remembering the Communist Past in Albania: The Case of Bunk'Art Project <i>Konstantinos Giakoumis</i>, European University of Tirana On the Politics and Pragmatics of Memory and Oblivion: Post-Communist Attitudes towards Communist Museology Approaches in Albania Moderator: <i>Irena Myzeqari</i>, European University of Tirana</p>
14:45 - 15:00	COFFEE BREAK
15:00 - 16:15	<p>Session 4: PUBLIC DISCOURSES AND PRIVATE MEMORIES <i>Francesco Iacono</i>, University of Cambridge Communist Heritage and the Memory of Communism in Post-Socialist Albania: Between Public Discourses and Private Recollections <i>Blerina Kellezi</i>, <i>Clifford Stevenson</i>, <i>Aurora Guxholli</i>, Nottingham Trent University Remembrance, Psychological Wellbeing and Intergroup Relations <i>Gilles de Rapper</i>, Institute for Mediterranean, European and Comparative Ethnology, Aix-en-Provence Photography and Remembrance. Questioning the Visual Legacy of Communism and its Reception in Contemporary Albania Moderator: <i>Julie Vullnetari</i>, University of Southampton</p>

16:15 - 17:00	<p>Session 5: POSTER PRESENTATIONS <i>Brisejda Lala</i>, University of Tirana Albanian–Soviet Union Relations in Private and Collective Memory <i>Rashela Shehu</i>, Independent researcher Creation of Places of Collective (Communist) Memory in the Public Space <i>Romina Kali</i>, Independent researcher Memories and Post–Communist Treatment of Former Persecuted Families of Shkodra <i>Leonora Laçi</i>, Independent researcher Reçi’s War in the Memory of People Yesterday and Today Moderator: <i>Sonila Danaaj</i>, University of Jyväskylä</p>
18 November	
<p>9:00 - 15:30 Venue: Tirana International Hotel, Classic Conference Room</p> <p>International Conference “BETWEEN APATHY AND NOSTALGIA: Public and Private Recollections of Communism in Contemporary Albania”</p>	
9:00 - 9:30	Welcoming Coffee
9:30 - 10:00	<p>Session 6: PERSPECTIVES FROM THE REGION <i>Cristian Vasile</i>, Romanian Academy of Sciences Remembering Communism in Romania: The Role of Historical Commissions Moderator: <i>Idrit Idrizi</i>, University of Vienna</p>
10:00 - 11:15	<p>Session 7: COMMUNISM IN ACADEMIC RESEARCH, FICTION, MEDIA <i>Federico Boni</i>, Università degli Studi di Milano Specters of Communism. Albanian (Post) Socialist Studies and the Repression of Communist Legacies <i>Elidor Mëhilli</i>, Hunter College, City University of New York “The Dictatorship’s Archive” <i>Brikena Smajli</i>, European University of Tirana A Poetic of Memory through Novel Narrativeness and Metanarratives of New Albanian Literature Moderator: <i>Kostantinos Giakoumis</i>, European University of Tirana</p>

11:15 - 11:30	COFFEE BREAK
11:30 - 12:15	<p>Session 8: COMMUNISM REMEMBRANCE AND YOUTH</p> <p><i>Jonila Godole</i>, University of Tirana & IDMC New Generation and the “Borrowed” Memory on Communism</p> <p><i>Irena Myzeqari</i>, European University of Tirana A “Loaned” Memory and a “Bittersweet” Nostalgia – How Youth Remember Communism</p> <p>Moderator: <i>Blerina Kellezi</i>, Nottingham Trent University</p>
12:15 - 13:00	<p>Session 9: PRIVATE RECOLLECTIONS AND EXTERNAL VIEWS</p> <p><i>Andreas Hemming</i>, German–Albanian Friendship Association “Did I not see, or Did I not Want to See?” Former West German Communist Activists Remember Albania</p> <p>Moderator: <i>Brikena Smajli</i>, European University of Tirana</p>
13:00 - 14:00	LUNCH
14:00 - 15:15	<p>Session 10: PRIVATE RECOLLECTIONS</p> <p><i>Idrit Idrizi</i>, University of Vienna From Demonisation to Glorification: Typologies of Privately Remembering Communism in Contemporary Albania</p> <p><i>Irida Vorpsi</i>, University of Tirana & University of Vienna Communism in the Minds and Souls: Of Nostalgia and Forgetfulness in Post-Communist Albania</p> <p><i>Julie Vullnetari</i>, University of Southampton & Russell King, University of Sussex “Dancing in the Mouth of the Wolf”: Remembering Everyday Life at the Border in Socialist Albania</p> <p>Moderator: <i>Rigels Halili</i>, University of Warsaw & Nicolaus Copernicus University of Toruń</p>
15:15 - 15:30	CONCLUSIONS
19:00	DINNER

Autorët

Federico BONI është profesor i sociologjisë së kulturës dhe komunikimit në Universitetin e Studimeve në Milano (Itali), ku drejton programin e masterit në komunikimin publik dhe atë të korporatave. Ai ka publikuar gjerësisht në fushën e studimeve kulturore dhe të komunikimit. Punimi i tij më i fundit është një artikull mbi studimet kulturore shqiptare bashkëkohore (Studime Shqiptare: Albanian Cultural Studies between Postcolonialism and Postsocialism, me Admir Perlekën, 2017). Disa nga botimet e tij janë: Sociologia dell'architettura (me Fabio Poggi, Carocci, Romë, 2011); Sociologia della comunicazione interpersonale (Laterza, Romë-Bari, 2008) dhe Teorie dei Media (Il Mulino, Bolonjë, 2006). Studimi i tij aktual fokusohet në studimet postkoloniale/ post-socialiste, orientalizmin/ ballkanizmin dhe studimet kulturore shqiptare. E-mail: federico.boni@unimi.it.

Konstantinos GIAKOUMIS është profesor i asociuar i historisë së artit në Departamentin e Arteve të Aplikuara në Universitetin Europian të Tiranës. Ai ka mbrojtur doktoraturën në “Qendrën për Studime Bizantine, Osmane dhe Moderne Greke” të Universitetit të Birminghamit. Fushat e tij të kërkimit përfshijnë tema të ndryshme të historisë kulturore, shoqërore dhe ekonomike të Ballkanit nga Mesjeta deri në kohët moderne. Interesi i tij në studimet e kujtesës së regjimeve komuniste vjen nga punimet krahasimore mbi vazhdimësinë dhe diversitetin e institucioneve deri në kohët moderne.

Jonila GODOLE është pedagoge në Universitetin e Tiranës, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit. Ajo ka studiuar ndër të tjera shkencat politike dhe sociologji në Universitetin “Johann Wolfgang Goethe”, Frankfurt am Main, dhe ka përfunduar doktoraturën në kulturën e gazetarisë në Shqipërinë post-komuniste, në Universitetin e Tiranës. Godole ka qenë një nga gazetaret e para të shtypit të pavarur në Shqipëri pas rënies së regjimit komunist, e njohur sidomos për intervistat politike. Ajo është autore e monografisë “Gazetaria shqiptare në tranzicion” (Papyrus 2014) dhe ndër të tjera bashkautore e artikullit “Shqipëria: Nevoja për dialog në media për internshipet” publikuar nga Programi i Medias i KAS-it në “Kërkesat për Mësimin e Gazetarisë Moderne” (2016). Fushat e saj

të studimit përfshijnë profesionalizmin e gazetarisë në Shqipëri, sistemet krahasuese të medias dhe komunikimin politik. Prej vitit 2014 Godole është drejtore ekzekutive e Institutit për Demokraci, Media dhe Kulturë, fokusi i të cilit përqendrohet ndër të tjera në ndërgjegjësimin e të rinjve për të shkuarën komuniste të vendit. Email: jonila.godole@idmc.al.

Idrit IDRIZI është asistent shkencor në Institutin për Historinë e Europës Lindore të Universitetit të Vjenës. Ka studiuar histori dhe të drejtat e njeriut me rezultate të shkëlqyera dhe ka doktoruar në histori me rezultate të shkëlqyera në Universitetin e Vjenës. Disertacioni i tij “Herrschaft und Alltag im albanischen Spätsozialismus (1976–1985)” [Sundimi komunist dhe jeta e përditshme në periudhën e socializmit të vonë në Shqipëri (1976–1985)] është vlerësuar me çmimet “Richard G. Plaschka” të Akademisë së Shkencave të Austrisë, “Grete Mostny” të Fakultetit të Historisë dhe Shkencave të Kulturës të Universitetit të Vjenës dhe “Michael Mitterauer për studime në fushën e historisë sociale, kulturore dhe ekonomike në Vjenë” dhe sapo është botuar nga shtëpia botuese De Gruyter Oldenbourg. Fusha e hulumtimit: Komunizmi dhe kujtesa mbi komunizmin në Shqipëri dhe Europën Juglindore. Email: idrit.idrizi@univie.ac.at.

Alsen KOKALARI ka përfunduar studimet bachelor në degën e Ekonomiksit në Universitetin e Pireusit, si dhe ka një diplomë masteri në menaxhim kulturor nga Universiteti Panteion i Shkencave Politike dhe Sociale në Athinë, Greqi. Ajo ka prezantuar artikuj në konferenca akademike dhe ka botuar një artikull akademik në bashkëpunim me studentë të tjerë pasuniversitarë mbi transformimin e peizazhit si pasojë e kushteve historike dhe politike në fshatin Gjonomadh, në Shqipëri. Fushat e saj të interesit përfshijnë studimin e kulturës dhe ideologjisë në vendet e Europës Lindore dhe Qendrore, me fokus Shqipërinë. Email: alsena.kokalari@gmail.com.

Daniela KOLEVA ka doktoruar në sociologji në Universitetin e Sofjes. Është profesoreshë asociuar në Departamentin e Historisë dhe Teorisë së Kulturës në Universitetin e Sofjes dhe studiuese asociuar e Qendrës së Studimeve të Avancuara në Sofje. Fushat e saj të interesit janë historia gojore dhe antropologjia e socializmit dhe e postsocializmit, kujtesa

sa biografike dhe kulturore, politikat e kujtesës dhe trashëgimisë. Ajo ka publikuar një monografi mbi “rrjedhën e jetës normale” në Bullgarinë socialiste dhe disa kapituj librash dhe artikuj në revistat ndërkombëtare peer-reviewed, si dhe është bashkëredaktore shkencore e vëllimeve 20 Years after the Collapse of Communism: Expectations, Achievements and Disillusions of 1989 (Peter Lang 2011); Negotiating Normality: Everyday Lives in Socialist Institutions (Transaction, 2012); Ageing, Ritual and Social Change: Comparing the Secular and Religious in Eastern and Western Europe (Ashgate, 2013); From Literature to Cultural Literacy (Palgrave Macmillan, 2014).

Afrim KRASNIQI është kërkues shkencor në Institutin e Historisë të Akademisë së Studimeve Shqiptare dhe profesor i shkencave politike në Universitetin e Tiranës. Ai ka një doktoraturë nga Universiteti i Tiranës dhe master nga Universiteti i Viadrinës (Frankfurt Oder, Germany). Ai ka qenë deputet në Kuvendin e Shqipërisë, këshilltar politik i dy presidentëve shqiptarë dhe vazhdon të shkruajë në disa media. Ka publikuar disa libra për proceset e tranzicionit, partitë politike, shoqërinë civile, zgjedhjet dhe demokracinë në Shqipëri dhe vendet e Europës Juglindore.

Brisejda LALA ka një diplomë masteri në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe aktualisht është kandidate për titullin “doktor” në histori tek Universiteti i Tiranës. Ajo ka qenë pedagoge me kohë të pjesshme e historisë bashkëkohore në universitetin “Aleksandër Moisiu” në Durrës, dhe që prej vitit 2016 është anëtare bordi, koordinatore e marrëdhënieve të jashtme e Shoqatës së Mësuesve të Historisë (ALBNA). Në 2017, në kuadër të bursës që mori nga Institutit për Demokraci, Media dhe Kulturë, përgatiti ekspozitën “Propaganda gjatë diktaturës komuniste”.

Gilles de RAPPER është studiues në Institutin për Etnologjinë Mesdhetare, Evropiane dhe Krahasuese, në Aix-en-Provence, Francë. Kërkimi i tij kryesor përqendrohet te prodhimi dhe përdorimi i fotografisë në Shqipërinë socialiste. Ky është njëkohësisht një studim i historisë gojore që fokusohet në përshtatjen e fotografisë në këtë kontekst të veçantë dhe synon të kuptojë më mirë përmes këtij objekti funksionimin e shtetit socialist, ashtu edhe një reflektim mbi fotografimin si një objekt i kërkimit antropologjik i cili, përtej rastit shqiptar, interesohet për studimin e mar-

rëdhënieve midis njerëzve dhe fotografive nga perspektiva e një etnografie të fotografisë. Studimi i tij përqendrohet te fotografitë familjare dhe të shtypit, si dhe te kushtet e transmetimit dhe ruajtjes së fotografive dhe te roli i tyre në gjendjen dhe ruajtjen e kujtesës në socializëm.

Kailey ROCKER është kandidatë për titullin “doktor” në Departamentin e Antropologjisë të Universitetit të Karolinës së Veriut, Chapel Hill (UNC). Ajo ka kryer studimet master në antropologjinë kulturore nga UNC dhe bachelor në sociologji dhe antropologji nga Kolegji Millsaps në Xhakson, Misisipi. Projekti i saj aktual studimor ndjek prurjet e projekteve të kujtesës historike të periudhës socialiste në Shqipëri dhe fokusohet në veçanti në angazhimin e të rinjve.

Cristian VASILE është studiues në Institutin e Historisë “Nicolae Iorga” të Akademisë Rumune (Bukuresht). Ai punon në programin studimor Rumania dhe Europa në shek XX. Është autor i shumë librave të botuar në rumanisht. Fushat e tij të interesit janë: historia e regjimit komunist në Rumani; feja dhe politika; historia e elitave politike, fetare dhe kulturore të Rumanisë; politikat e kujtesës në Europën Lindore postkomuniste.

